



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 174, Datë 22.06.2026

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “5GX ENERGY” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 11, pika 3 e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 13, 14, pika 9 dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1570/7 prot., datë 18.06.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1570 prot., datë 12.05.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse.
- Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 272, datë 04.05.2023 dhe Kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.06.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) shoqëria është pajisur me të drejtën Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.

- Në nenin 11, pika 3, e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, parashikohet se: “Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin objektet e tyre ose objekte të tjera të depozitimit duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet”.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 133, datë 21.05.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.05.2026 dhe 23.05.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 01.06.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 1570/3, datë 26.05.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.
- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 1570/4, datë 26.05.2026. Me shkresën nr. 1570/6 prot., datë 02.06.2026, ERE ka njoftuar edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1570/5 prot., datë 01.06.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.
- Për sa argumentuar nga shoqëria në lidhje me kapacitetin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë, në kushtet kur kapaciteti prodhues nuk i mbivendoset apo shtohet kapacitetit aktual të licencuar, për qëllime të modifikimit të kësaj licence dhe pasqyrimit të elementeve përkatëse në Aneksin A të saj, ERE do të njohë fuqinë e instaluar prej 10 MW.
- Në këto rrethana, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që brenda datës 01.10.2026 të raportojë në ERE në lidhje me ecurinë e zbatimit të projektit për vendosjen e veprave ndihmëse sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Brenda datës 01.10.2026, shoqëria duhet të raportojë në ERE në lidhje me ecurinë e zbatimit të projektit për vendosjen e veprave ndihmëse sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI